



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.08.2024
REFERENC-Ë:	02-400/01-0058673/24/2
PËR/ZA/TO:	Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit
KOPJE :	Bedri HAMZA - Kryetar i Komunës së Mitrovicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Igballe ISLAMI – Drejtore për Buxhet dhe Financa
NGA/OD/FROM:	Zenel ÇITAKU – Udhëheqës për Buxhet dhe Financa / ZKRF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për Dëgjimet Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit të vitit 2025-2027

E nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkorës 2025/01, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në koordinim me kryetarin e Komunës së Mitrovicës, në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive dhe Grupin Punues për dëgjime buxhetore 2025-2027 kemi bërë të gjitha përgaditjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgaditjen e buxhetit për vitin 2025 dhe planifikimin për vitet 2026 dhe 2027.

Përgaditja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 9 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Duke u referuar në vendimin e kryetarit për formimin e Grupit Punues për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 2025-2027 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, gjegjësisht pikës 4, grupi punues ka hartuar raportin me shkrim dhe i njëjti i dorëzohet kryetarit. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektorinke dhe në takime direkte).

Në procesin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025-2027 i kemi përfshi gjithsej 5 dëgjime buxhetore, prej të cilave dëgjimi i parë ka qenë për KAB - Komunal 2025-2027 dhe katër dëgjime për planifikimin e buxhetit komunal 2025-2027.

Metodat e konsultimeve	Data/Kohë-zgjatja	Numri i pjesëmarrësve			Numri i atyre që kanë dhënë komente	Numri i kërkesave të pranuar
Takime të drejtpërdrejta me gjithë qytetarët e komunës të organizuara nga Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2025-2027	16.07.2024 23.07.2024	F 41	M 32	T 73	39	52

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjime publike janë pjesë e raportit, ndërsa raporti i detajuar është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Me respekt!

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna nga qytetarët, të cilat i obligon drejtorët e drejtorive komunale që t'i shqyrtojnë këto kërkesa dhe varësisht nga natyra e kërkesës së qytetarëve të përgjigjet drejtoria përkatëse në dy kolonat e fundit të tabelës sipas kërkesës së tabelës.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat /Sygjerimet/ Komentetet	Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/sygjerimi i pranuar, pjesërisht i pranuar/ apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
Dëgjimi buxhetor me qytetarë për Draft-Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesë për ndriqimin e rrugës kryesore “Martirët e Vinarcit” 2. Rregullim i tretuarit në rrugën “Martirët e Vinarcit” (3 km gjatësi). 3. Kërkesë për ansore tek vendi i quajtur “kërrshi”. 	Lulzim Hasani Vinarc i Eperm		
	<ol style="list-style-type: none"> 4. Rregullimi i rrugëve në fshatin Bajgorë (Mullinjët, Hakif Mehmeti, Zahir Istrefi, Ramë H Uka, Alpet shqiptare, Dy Martiret Osman Musa). 5. Rregullimi 4 Pritoreve. 6. Ndriqimi publik. 7. Rregullimi I tretuareve, ujësjellësit dhe ujrave të zeza. 8. Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës në fshatin Kaqandollë. 9. Kërkesë për ndriqim public në fshatin Kaqandollë. 10. Kërkesë për rregullimin e ujësjellësit, ndriqimin public dhe ujrat e zeza në fshatin Kovaqicë. 11. Rregullimi dhe asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Kaqandollë me fshatin Orzhan. 	Faton Beqiri Bajgorë		
	<ol style="list-style-type: none"> 12. Kërkesë për një qender për Kultur, Rini dhe Sport, të largohet qendra kolektive dhe në atë parcel të ndertohej kjo qender. 13. Ndertimin e një objekti për strehimin e të moshuarve 	Salih Meha Fsh. Shipol		

kuvendit 16.07.2024, E Martë ora 14:00	parcela është me mbi 2.5 hektar, që është një kapital i madhë për Mitrovicën. 14. Kamerat e sigurisë.			
	15. Të perfundoj tretuari i filluar në fillim të këti viti, të bëhet edhe ndriqimi. 16. Në lagjen “Kllovit” të bëhet ndertimi I rrugës nga zona ku bashkohet me fshatin Zupç si dhe ndriqimi i lagjës. 17. Të rregullohen edhe disa rrugë dhe ujrave të zeza.	Haxhi Salihu Fsh.Koshtovë		
	18. Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës së fshatit Koprivë, e cila e ka projektin e detajuar.	Xhelazim Baliu Fsh. Koprivë		
	19. Renovimi i ndërtesës sportive ish “Partizani” e tani “Fatime Xhaka”. 20. Renovimi dhe izolimi i ndërtesës së Omni Sportit. 21. Kërkesë për mbikqyrje profesionale në ndertim të ndërtesave.	Asllan Vitaku Mitrovicë		
	22. Ndertimi I rrugës “Ramadan Ahmeti” kërkohet vendosja e një tretuarit. 23. Ndertimi I rrugës që lidh skenderajin nga ana e djatht, rrugë që fillon nga lagja Bashkimi dhe vazhdon tek vullkanizeri Behari (150m), dhe vendosja e 3 poqave elektrik.	Musli Osmani Fsh. Zhabar I ulët		
	24. Kërkesë për realizimn e kërkesave të derguara në drejtorit perkatese (kerkoj realizimin nga Kryetari i Komunës- të realizohen në buxhetin 2025-2027).	Osman Cimili Fsh. Melenic		
	25. Rregullimi i ujrave të zeza (të mbyllura). 26. Ndriqimi i fshatit Frasher i vogël. 27. Rregullimi I rrugës “Faruk	Mustaf Preshtreshi Fshati Frasher		

	<p>Spahija”(80m).</p> <p>28. Kapaciteti i pompave të ujit është i vogël (fshatarët mbesin pa ujë të pijes).</p>			
	<p>29. Rregullimi I ujrave të zeza.</p> <p>30. Përfundimi i 3 rrugëve të lëna në gjysmë.</p>	Asllan Hasani Fsh. Zhabar i poshtëm		
	<p>31. Rregullimi i rrugëve të dëmtuara në fshatin Vllahi dhe Ziaq.</p> <p>32. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Vllahi – Zhazh (6km).</p> <p>33. Rregullimi i ujës-jellësit ne fshatin Vllahi.</p>	Safet Kurti Fsh. Vllahi		
	<p>34. Rregullim i tretuarit në rrugën “Shaqir Avdiu”.</p> <p>35. Ndriqimi publik në lagje.</p> <p>36. Rregullim i rrugës “Mulliri i vjeter”.</p> <p>37. Përfundim i rregullimit të rrugës së “Jazit”.</p> <p>38. Mbyllja e pusetave.</p> <p>39. Renovimi i shkollës.</p> <p>40. Ndertimi i një salle sportive.</p> <p>41. Kërkesë për qerdhe të fëmijëve.</p> <p>42. Instalimi i kamerave në oborrin e shkollës në Zhabar dhe në hapsirat tek liqeni Akomulues.</p>	Xhafer Jaha Fsh. Zhabar i poshtëm		
<p>Dëgjimi I Dytë buxhetor Kulturë Rini dhe Sport, Shoqërit Civile dhe Komunitete tDraft-Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 17.07.2024, e Merkurë ora 14:00</p>	<p>43. Përkrahje ekstra financiare për KF Mitrovica – Femrat në garat Evropiane në ligën e kampioneve për femrat.</p>	Asllan Vitaku Mitrovicë		
	<p>44. Të zvoglohet perkrahja financiare për klubet e futbollit dhe basketbollit për meshkujt dhe të rritet perkrahja financiare për klubet e hendbollit për femrat dhe meshkujt, basketbollit dhe futbollit të femrave.</p> <p>45. Të perkrahjet financiarisht KA Trepça dhe Shahu Minatorët.</p> <p>46. Të sqarohet qështja proneso-juridike e stadiumit “Xhemajl Isufi”-Xheki spse BE ka investuar për të gjitha komunitetet dhe jo vetëm për SH.F “Australia “.</p>	Krenar Kaçaniku Mitrovicë		

47. Të largohet “Diagonia” nga prona e palestres Minatori dhe të ju ipen zyret për klubet e qytetit.			
48. Ndarje të buxhetit për hapsira publike, në drejtim të permisimit të jetës në komunitet. 49. Investime në prietore (stacione).	Blerta Brezhnica Ojq Pse Mitrovicë		
50. Subvencionet për klubet të planifikohen me kohë deri ne muajin Mars-Prill. 51. Në KH Trepça subvencione me rritjen e buxhetit për vitin 2025 nga ana e DKRS-Mitrovicë.	Taib Kabashi KH Trepça		
52. Kërkesë për përkrahje financiare për klubin e basketbollit Trepça “Veteranet”. 53. Renovimi i palestres së “ Omni sportit”, si dhe kordinime për aktivitete të klubit. 54. Të ndertohen edhe disa hapsira të hapura për fusha të basketbollit.	Naim Hajrizi Mitrovicë		
55. Përbërja e komisioneve të cilat vendosi për shpërndarjen e subvencioneve për organizata të jetë publike paraprakisht dhe personat të cilët zgjedhën të mos jenë njerez jo kredibil dhe po ashtu mos të jenë homofob, seksist apo politikisht të përfshirë. 56. Mjete për diplomaci kulturore. 57. Renovimi i qendrës së kulturës mbrapa, dhe renovimi i “Omni sportit”.	Neri Ferizi Mitrovicë		
58. Kërkesë që në komisionet përzgjedhëse të ketë përfaqësues rinor.	Mehmet Salihu		
59. Kërkesë për përkrahje financiare në emër të K.Ç. “Trepça”për t’i realizuar aktivitetet e tyre për vitin 2025, I duhen rreth 8,000.00 Euro. Të gjitha aktivitetet në total janë 23 gara Brenda dhe jashtë vendit.	Edmond Kumnova Mitrovicë		

	<p>60. Asfaltimi i rrugës “Ilmi Cimili” dhe “Voce Gimaj”.</p> <p>61. Shtrimi me zhavor i rrugës “Halim Cimili”.</p> <p>62. Asfaltimi i rrugicave në lagjën “Meholli” dhe “Hysenaj”.</p> <p>63. Të shiqohen mundësit për të siguruar ujin e pijshëm në këto fshatra.</p> <p>64. Të shtrohen disa rrugë me zhavor në fshatin Maxherë.</p>	Osman Cimili Fsh. Melenicë		
	<p>65. Kërkesë për ekspozit të pikturave.</p> <p>66. Kërkesë për punëseim (drejtimi dizajn modern).</p>	Sahadete Hajrizi Mitrovicë		
<p>Dëgjimi i Tretë buxhetor Shëndetsi Draft-Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 18.07.2024, e Enjtë ora 14:00</p>	<p>67. Rezervar të ujit për QMF-AMF-të.</p> <p>68. Vendosja e klimave.</p> <p>69. Gëlqerosja – renovimi Bair 1</p> <p>70. Aneks në AMF- Kçiq.</p>	Meleqe Morina		
	<p>71. Kërkesë për paisje moderne për mirëmbajtje të objektit si dhe një puntorë mirëmbajtës.</p> <p>72. Rinovimi në terësi i AMF – Fidanishtë.</p>	Lutvi Peci QMF - Iliridë		
	<p>73. Kërkesë për 3 kondicionerë (klima).</p> <p>74. Ngjyrosja (gelqerosja) e objektit brenda.</p> <p>75. Vendosja e një piste për persona me nevoja të veqanta.</p> <p>76. Renovimi i bodrumit QMF- Bajr 2.</p> <p>77. Vendosja e një dere që lidh bodrumin me katin e parë.</p> <p>78. Sigurimi i ngrohjes elektrike.</p> <p>79. Rrethoja e objektit.</p>	Bajram Rama QMF- Bair 2		
	<p>80. Kërkesë që të bëhet zgjedhje për klimatizimi dhe ventillimin e hapsirave, duke pasur parasysh temperaturat e larta dhe mundësia e dëmtimeve të barnave nëpër qendra shkak temperaturave të larta.</p>	Sokol Haliti		
	<p>81. Aftësimi apo sigurimi i një aparati të ri për ftohje të ujit të pijshëm në repartin e stomatologjisë.</p>	Eshref Hasani		
	<p>82. Kërkesë për mjete pune si frizere, per zgjerim te biznesit.</p>	Arjeta Behrami Mitrovic		

Dëgjimi i Katërtë buxhetor Gratë dhe Vajzat Draft- Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 23.07.2024, e Martë ora 14:00	83. kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale) biznes individual.	Violeta Islami Mitrovicë		
	84. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale) biznes individual. 85. Kërkesë për panairë (për të promovuar produktet tona me gatime tradicionale).	Arbenita Brahimi Shipol		
	86. Kioska për shitje të produkteve. 87. Mbatje më e shpeshtë e panairëve.	Fatmire kurti Mitrovicë		
	88. Merrem me blegtori dhe gatime tradicionale, kërkoh ndihme rreth një shtalle. 89. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).	Vjollca tupella Fsh. Këciq		
	90. Kërkesë për mjete pune, salon për frizere.	Shadije hasani Mitrovicë		
	91. Kërkesë për paisje (rrobaqepsi).	Kimete Arifi Rr. "Cen Stantergu"		
	92. Rregullimi i infrastruktures në Shupkovc. 93. Krijimi i mundësive për punësim.	Syzana Preteni Fsh. Shupkovc		
	94. Kërkesë për kioske (për shitje të produkteve punëdore). 95. Kërkesë për mbajtje të panairëve më shpeshë.	Sevdije Aliu Mitrovicë		
	96. Si themeluse e OJQ "Hareja" në Mitrovicë kërkoh përkrashje për marrjen e një lokali për takime me grupin e grave.	Hadije Ahmeti Mitrovicë		
	97. Kërkesë për kioske - lokal (për shitje të produkteve punëdore). 98.	Kumrije Kamberi Mitrovicë		
	99. Kërkesë për një lokacion për shitjen e produkteve punëdore,ushqime tradicionale etj. 100. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).	Sadete Brahimi Broboniq		
	101. Përkrashje financiare për Strehimoren QMGF "Raba Voca".	Fidane Hyseni Rr." Ramadan Peci"		
	102. Kërkesë për mjete	Shyhrete		

	pune si frizere, për zgjerim të biznesit.	Brahimi Fsh. Kçiq i Madhë		
	103. Kërkesë për kioske (per shitje të produkteve punëdore). 104. Kërkesë për mbajtje të panairove më shpeshë.	Hamide Tahiri Mitrovicë		
	105. Kërkesë për bursa per nxënësit të shkollave të mesme. 106. Kërkesë për psikologë në shkollat e mesme.	Fatmire Gerxhaliu Rr. "Zahir Pajaziti" Mitrovicë		
	107. Asfaltimi i rrugës "Faqja e Lemutë" në Broboniq, e cila është lënë në gjysmë.	Xhevrije Doroci Fsh. Broboniq		
	108. Kërkesë për kioska (për gratë që merren me artizanale).	Xhylinaze Zatriqi Mitrovicë		
	109. Kërkesë për mjete pune për zgjerim të biznesit blegtori.	Emine Brahimi Fsh. Kçiq Madhë		
	110. Kërkesë për zgjerim të rrugës kryesore Shupkocv – Zasellë, së paku deri tek restoranti në fshat.	Maliqe Mustafa Fsh. Zasellë		
	111. Kërkesë për perkrahje për punësim.	Sahadete Hajrizi Rr. "Avni Shabani"		
	112. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).	Shukrije Muharremi Mitrovicë		
	113. Kërkesë për mjete pune per zgjerim të biznesit (ushqime tradicionale). Kërkesë për mbajtje të panairove.	Arbenita Brahimi Shipol		
	114. Të rritet ndihma ose se paku dy herë në vit të subvencionohen gratë e sëmuara me kancer. 115. Të i'u sigurohen medikamente bazë (gratë e prekura me kancer). 116. Vazhdimi i pagesave të qirave. 117. Vazhdimi dhe rritja e përkrahjeve financiare dhe ushqimore.	Mitrovica Women association for Human Rights MWHR		

	<p>118. Të ndihmohen OJQ (me persona me aftësi të kufizuar) edhe financiarisht – Handikosi.</p> <p>119. Të ndahet një hapsir, object ku pensionistet mund të kalojnë kohën (mundesisht hapsira të posedoj mini bibliotekë dhe materiale për argëtim).</p> <p>120. Për grupin e grave “Gratë e Mitrovicës lexojnë” të ndahet një hapsirë ku ato mund të takohen dhe komentojnë romanet (shpresojmë në objektin e bibliotekës së re të gjendet një vend i tillë.</p> <p>121. Të rregullohet ndriqimi në lagjen “Adem Voca”</p> <p>122. Në lagjen “Adem Voca” në ambullantë nuk ka mjekë të rregulltë si dhe mungojnë vizitat e rregullta të mjekëve dhe barnat esenciale.</p> <p>123. Të përkrahen me bursa modeste vajzat e komunitetit ashkali si dhe punësimi i tyre.</p> <p>124. Hapja e biznesit të rrobaqepesisë në “Roma Mahallë”.</p> <p>125. Të riaktivizohet zyra policore e cila qe një kohë të gjatë është pa zyrtare policor.</p>			
	<p>126. Vendosja e kiosqeve të premtuara në një hapsirë të caktuar.</p> <p>127. Të percaktohet vendi i organizimit të panairove – sheshi Adem Jashari.</p> <p>128. Grante të vogela: për kavanoza dhe tenxhere për prodhimin e turshive, ajvarit.</p> <p>129. Organizimi i vizitave studiomore.</p> <p>130. Transporti për ndërrmarrëse të cilat marrin pjesë në panairë në qytete të tjera të Kosovës.</p> <p>131. Të rregullohet rruga</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR-</p>		

	<p>“Kristalet” në Trepçë.</p> <p>132. Ulja e taksave për biznese të vogla fillestare.</p> <p>133. Kërkesë për ndryshim të kriterëve për subvencionim (në favor të grave).</p> <p>134. Subvencionim i grave që merren me punime artizanale.</p> <p>135. Subvensioni i grave ndërrmarrëse për zgjerim biznesi.</p> <p>136. Të organizohen me shumë panairë ndoshta në cdo dy muaj.</p> <p>137. Të organizohen vizita studimore në rajon për shkëmbim të përvojave dhe ide për zhvillim të bizneseve të reja.</p> <p>138. Të organizohen trajnime për veprimtari të cilat merrën gratë.</p>	<p>Kërkesat e grave ndërrmarrëse</p>		
	<p>139. Të sigurohet transporti për antarët e organizatës “Së Bashku”.</p> <p>140. Të i’u mundësohet qasja në katete e epërme të objektit të komunes për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>141. Në objekt të komunës të vendosen tualete për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>142. Tualete publike në qytet për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>143. Të vendosen në rruë vija për të verbër dhe për karroca.</p> <p>144. Të renovohet zyra e shoqatës së të verbërve.</p> <p>145. Mundesi punësimi për persona me aftësi të kufizuar punë me kohë të pacaktuar dhe jo vetëm praktik për 6 muaj.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e personave me aftësi të kufizuar</p>		
	<p>146. Bursa për vajzat Rome/Ashkalike.</p> <p>147. Mundesi e regjistrimit të vajzave Rome/Ashkalike në shkollën e mesme të mjeksisë.</p>			

	<p>148. Stimulimi i vajzave për tu regjistruar në shkollën e mesme të teknikes perms përkrahjes me bursa.</p> <p>149. Bursa për vajza nga viset rurale.</p> <p>150. Ndertimi i konviktit për vajzat nga viset rurale.</p> <p>151. Angazhim I mësimdhënësive mbështetës për nxënësit me ngecje fizike.</p> <p>152. Të ndahet më shumë buxhet për mjete digjitale.</p> <p>153. Emerimi i psikologëve në shkolla.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e grave mësimdhënëse</p>		
	<p>154. DKA të parashehë buxhet për transport të mësimdhënësive dhe nxënësëve.</p> <p>155. Të i'u mundësohet nxënësëve të hapin një kuzhinë në shkollë (të i'u sigurohen paisjet përkatëse).</p> <p>156. Të shpërblehen me bursa nxënësit e shkëlqyeshëm.</p> <p>157. Më shumë mjete për gjelbrimin e hapsirave shkollore.</p> <p>158. Mbështetje shtesë me paisje shkollore për nxënësit me kushte ekonomike të vështira.</p> <p>159. Në shkollat ku nuk ka qasje për karroca, të ndërtohen.</p> <p>160. Të rritet shuma e përkrahjes për organizatat që të ketë aktivitete më cilësore.</p> <p>161. Ndërrim i rregullorës për bursat e studenteve (të i'u mundësohet edhe studentëve të vitit të parë).</p> <p>162. Të organizohen sesione informuese në fshatra.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e të rinjëve</p>		
	<p>163. Të përkrahen klubet e grave.</p> <p>164. Të rritet buxheti mbështetës i OJQ-ve sportive.</p> <p>165. Të ndërtohet një fushë sporti për klubin futbollistik të grave.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e</p>		

	<p>166. Thirrjet publike për mbështetje të bëhen në fillim të vitit.</p>	<p>klubeve sportive</p>		
	<p>167. Të rritet buxheti për ndarjen e granteve për grupet e grave të shoqëris civile.</p> <p>168. Në bashkëpunim me OJQ e grave të organizojnë trajnime për zyrtarë komunal (për mekanizmat mbrojtës nga dhuna, vendor dhe ndërkombetar).</p> <p>169. Të sigurohen hapsira – zyra OJQ të grave aktive.</p> <p>170. Të rritet shuma e grantit për përfaqësuesit e granteve nga zyra për barazi gjinore.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e përfaqësuesve të shoqërisë civile</p>		